



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE FERIZAJ

Numri i lëndës: 2023:260138
Datë: 09.10.2024
Numri i dokumentit: 06271569

2023:260139

Gjykata Themelore në Ferizaj, Departamenti i Përgjithshëm, me gjyqtarin Armend Ahmeti, në çështjen juridike kontestimore të paditësit Xh.R nga Shtimja, të cilin e përfaqëson avokati Labinot Buzuku nga Prishtina, rr. Nekibe Kelmendi, ndaj të paditurës Komuna Shtime-DKA, me objekt kontesti kompensim për diferencë për kualifikim shkollor – licencim, vlera e kontestit 4698,59€, jashtë seancës më datë 09.10.2024 mori këtë:

A K T V E N D I M

HEDHET POSHTË padia me shenjën C.nr.2023:260139 e paditësit Xh.R nga Shtimja kundër të paditurës Komuna Shtime-DKA, me objekt kontesti kompensim për diferencë për kualifikim shkollor – licencim, për shkak të ekzistimit të gjyqvarësisë (litispendencës).

A r s y e t i m

Paditësi, të cilin e përfaqëson avokati Labinot Buzuku nga Prishtina ka ushtruar padi në këtë gjykatë me dt. 29.11.2023 kundër të paditurës, me objekt kontesti kompensim për diferencë për kualifikim shkollor – licencim, vlera e kontestit 4698,59€.

I autorizuari i paditësit av. Labinot Buzuku nga Prishtina ka dorëzuar në këtë gjykatë më dt. 26.09.2024 parashtesë, në të cilën ka theksuar se e njoftojmë gjykatën se e kemi pranuar aktvendimin e gjykatës për plotësim të padisë. Paditësi e ka të përfunduar kontestin për licencim për të cilën bëhet edhe fjalë, në lëndën C.nr.2023:260147 dt. 31.07.2024, me objekt kontesti shujtë ditore, inflacion si dhe licencim, e në rast se ka tjetër padi për të njëjtin kontest atëherë e tërheqim. Si shtojcë ja ka bashkangjitur Aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Ferizaj, Departamenti i Përgjithshëm C.nr.2023:260147, të dt. 31.07.2024.

Me leximin e Aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Ferizaj, Departamenti i Përgjithshëm C.nr.2023:260147, të dt. 31.07.2024, gjykata ka vërtetuar se aprovohet në tërësi kërkesëpadi e paditësit Xh.R nga Komuna Shtime ushtruar kundër të paditurës Komuna Shtime-DKA, si e bazuar, dhe detyrohet e paditura që paditësit në emër të kompensimit për ushqim gjatë punës, për periudhën kohore 01.09.2021-31.12.2020 për 77 ditë pune shumë prej 156€, si dhe për inflacion për vitin 2020 deri 22.11.2022 shumë prej 667€ si dhe për licencim për periudhën prej 01.10.2020-31.01.2023 apo për 30 muaj shumë prej 1660€ apo shumë e përgjithshme prej 2483€.

Gjykata pas analizimit të shkresave të kësaj lënde me shenjën 2023:260139 dhe Aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Ferizaj, Departamenti i Përgjithshëm C.nr.2023:260147, të dt. 31.07.2024, vlerëson se bëhet fjalë për çështjen e njëjtë (objekti i kontestit licencim), palët e njëjta, gjendja faktike dhe juridike esencialisht e njëjtë. Atëherë gjykata vendosi ta hedhë poshtë padinë në këtë çështje e cila udhëheqet me numrin 2023:260139, për shkak të litispendencës (gjqvarësisë).

Me shikimin në sistemin SMIL, vërtetohet se për lëndën C.nr.2023:260147 shkruan se statusi është “Apeluar” gjë që nënkupton se ndaj Aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Ferizaj, Departamenti i Përgjithshëm C.nr.2023:260147, të dt. 31.07.2024 është ushtruar ankesë dhe lënda gjindet në Gjykatën e Apelit.

Sipas nenit 262.3 të LPK parashihet që: “Gjatë kohës së ekzistimit të gjyqvarësisë për të njëjtën kërkesëpadi nuk mund të iniciohet gjykim i ri midis palëve të njëjta. Po që se, prapëseprapë, bëhet një gjë e tillë, gjykata e hedhë poshtë padinë.”, kurse sipas nenit 262.4 të LPK, gjykata gjatë gjithë procedurës, sipas detyrës zyrtare, kujdeset nëse është në zhvillim e sipër gjykimi tjetër për të njëjtën kërkesëpadi midis palëve të njëjta. Ndërsa sipas nenit 391, pika c) të LPK, përcaktohet se pas shqyrtimit paraprak të padisë gjykata me aktvendim e hedh poshtë padinë si të palejueshme po që se konstaton se: c) për çështjen e ngritur me padi ekziston gjyqëvarësia (litispendenca).

Nga të cekurat më lartë, gjykata duke u bazuar në nenin 142 të LPK, vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ-Departamenti i Përgjithshëm

Datë 09.10.2024

Gjyqtari

Armend Ahmeti

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi është e lejuar ankesa, në afat prej 15 ditësh, nga dita e marrjes së të njëjtit, përmes kësaj Gjykate, për Gjykatën e Apelit.